

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË KORPORATËN ELEKTROENERGJETIKE

SHQIPTARE

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare, me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare” për periudhën 01.01.2012 deri më 31.12.2013, dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 67 datë 30.06.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 1072/7, datë 30.06.2014, dërguar Z. Agron Hetoja Administrator i Përgjithshëm i Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Këshilli Mbikëqyrës të respektojë me rigorozitet zhvillimin e veprimtarisë së tij, duke u mbledhur jo më vonë se një herë në tre muaj në përputhje me nenin 10, pika 10.1, të Statutit të Shoqërisë.

Vazhdimisht

2. Këshilli Mbikëqyrës të shqyrtojë dhe miratojë në afat pasqyrat vjetore financiare, sipas përcaktimeve në Udhëzimin e METE nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, paragrafi IV, pika 7.

Brenda tremujorit të parë të çdo viti

3. Këshilli Mbikëqyrës të inkurajojë paraqitjen e Programit të zhvillimit ekonomik, si dhe të shqyrtojë e miratojë brenda datës 15 tetor të çdo viti, në përputhje me Udhëzimin e METE nr. 315, datë 08.04.2009 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror”, paragrafi III, pika 4.

Brenda datës 15 tetor të çdo viti

4. Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë të marrin masat e nevojshme për të kryer analiza dhe vlerësime të hollësishme teknike, ekonomike dhe financiare, në mënyrë që të shmangen në maksimum ndryshimet e pjesshme në programin e zhvillimit, siç edhe ka ndodhur gjatë viteve të mëparshme.

Vazhdimisht

5. Këshilli Mbikëqyrës, të referojë dhe të zbatojë me përpikmëri bazën ligjore të veprimtarisë dhe vendim-marrjes, për të shmangur mangësitë e evidentuara në periudhën e audituar.

Vazhdimisht

6. Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë, të marrin masa për miratimin Rregullores së Brendshme, në të cilën të implementohet ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe Udhëzimi i Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Menjëherë

7. Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë, të marrin masat e nevojshme që, për nivelin e pagave dhe të shpërblimeve të zbatojnë kërkesat e ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, si dhe kërkesat e Kodit të Punës, duke i harmonizuar ato me kontratën kolektive të punës dhe aktet e tjera të shoqërisë.

Vazhdimisht

8. Administratori i shoqërisë dhe departamentet përkatëse, të marrin masat e nevojshme për të përcaktuar dhe zbatuar procedura të rregullta në shpenzimet për udhëtim e dieta brenda vendit, duke i plotësuar me dokumentacionin justifikues sipas kërkesave përkatëse ligjore.

Vazhdimisht

9. Administratori i shoqërisë dhe departamentet përkatëse të marrin masat e nevojshme për hartimin e treguesve sa më real dhe të harmonizuar të investimeve, duke marrë parasysh krahas nevojave edhe mundësitë për burimin e financimit të tyre.

Vazhdimisht

10. Administratori i shoqërisë dhe departamentet përkatëse të marrin masat e nevojshme për zbatimin e procedurave të prokurimit publik për blerje me vlera të vogla, në kryerjen e shpenzimeve për blerje bileta udhëtimi jashtë vendit, si dhe likuidimin e shpenzimeve mbi bazën plotësimin e të gjithë dokumentacionit mbështetës financiar ligjor përkatës.

Vazhdimisht

11. Administratori i shoqërisë dhe departamentet përkatëse të marrin masat e nevojshme për programin sa më real të shpenzimeve telefonike të shoqërisë, bazuar në realizimin e viteve të mëparshme dhe kërkesat e zhvillimit ekonomik aktual dhe në të ardhmen.

Vazhdimisht

12. Administratori i shoqërisë dhe departamentet përkatëse të marrin masat e nevojshme për mirëadministrimin e shpenzimeve për karburant, duke përcaktuar dhe plotësuar fletë shërbimet që pasqyrojnë kilometrat e përshkruara prej tyre, cilësimin e destinacionit, distancave dhe nënshkrimin me përgjegjësi nga drejtuesi i mjetit, Specialisti i Sektorit të Shërbimeve dhe personat urdhërues, sepse në periudhën e audituar ka rezultuar se dy automjete për çdo muaj kanë përshkuar të njëjtin kilometrazh (nga 8,180 km për 11 ditë), në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”.

Vazhdimisht

13. Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë t’i kërkojnë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, që të sigurojnë burimet financiare të nevojshme për shlyerjen e overdrafteve, pasi në fundin e vitit 2013 janë në vlerën 30,132,731 mijë lekë, duke pësuar rritje të vazhdueshme, me pasojë rëndimin e gjendjes financiare të KESH Sha për mungesë të likuiditeteve.

Menjëherë

14. Këshilli Mbikëqyrës, Administratori i shoqërisë dhe Ministria e Energjisë dhe Industrisë të marrin masat e nevojshme administrative deri edhe gjyqësore për të arkëtuar shumën e detyrimit të CEZ Shpërndarje Sha prej 53,735,648.3 mijë lekë, rezultuar në fund të vitit 2013, të cilat po dëmtojnë seriozisht ecurinë e KESH Sha, duke e rënduar nivelin e borxhit për të garantuar furnizimin me energji elektrike të popullatës.

Menjëherë

15. Administratori i shoqërisë të marrë masat e nevojshme për standardizimin e organizimit dhe mbajtjes së kontabilitetit në qendër dhe në njësitë e gjenerimit, pasi në disa njësi mbahet me programe të kompjuterizuar dhe në disa të tjera me regjistrime në programin “Excel” në mënyre manuale, duke krijuar vështirësi në hartimin e bilancit të konsoliduar të shoqërisë dhe vlerësimin e saktë e në kohë të aseteve të shoqërisë.

Brenda vitit 2014

16. Administratori i shoqërisë dhe departamentet përkatëse të marrin masat e nevojshme për evidentimin, regjistrimin dhe ndjekjen sistematike e të vazhdueshme të kërkesave të arkëtueshme, duke i klasifikuar sipas afateve të maturimit të tyre.

Vazhdimisht

17. Këshilli Mbikëqyrës, Administratori i shoqërisë dhe Ministria e Energjisë dhe Industrisë të marrin masat e nevojshme administrative për detyrimin e CEZ Shpërndarje të saktësisimit dhe fillimit intensiv të vjeljes së detyrimit prej 40,691,823 mijë lekë të klientëve të pa arkëtuar nga shitja e energjisë para vitit 2006 nga OSSH (aktualisht CEZ Shpërndarje) të transferuar në KESH Sha, sipas Urdhrit të Ministrit nr. 500, datë 01.07.2008, si dhe të llogaritet shuma e provizioneve për detyrimet pa shpresë arkëtimi.

Menjëherë

18. Këshilli Mbikëqyrës, Administratori i shoqërisë dhe Ministria e Energjisë dhe Industrisë të bëjë një analizë të hollësishme të penalizimeve financiare të KESH Sha, duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për veprimet dhe mosveprimet e strukturave drejtuese e vartëse, pasi për vitet 2012-2013, shoqëria është ndëshkuar me penalitete e dëmshpërblime nga gjykata, organet përmbartimore dhe administrata tatimore në shumën 4,112,482 mijë lekë (203,967 mijë lekë në 2012 dhe 3,908,515 mijë lekë në 2013).

Menjëherë

19. Këshilli Mbikëqyrës, Administratori i shoqërisë dhe Ministria e Energjisë dhe Industrisë të bëjë një analizë të hollësishme të detyrimeve dhe të drejtave financiare, pasi KESH Sha nuk ka paguar detyrimet ndaj furnitorëve e kreditorëve, gjendja e të cilëve në fund të vitit 2012 (llogari të pagueshme dhe të tjera) është 15,032,883 mijë lekë (furnitorët për energjinë elektrike arrijnë në vlerën prej 4,815,366 mijë lekë në 2012 dhe 3,369,141 mijë lekë në fundvitin 2013), duke rrezikuar rritjen e kostos së likuidimit, si rezultat i penalizimeve për vonesa.

Menjëherë

20. Këshilli Mbikëqyrës, Administratori i shoqërisë dhe Ministria e Energjisë dhe Industrisë të marrë masat e nevojshme për sigurimin e burimeve të financimit për likuidimin e detyrimeve për

organet tatimore, ose shtyrjen e tyre për pagesë të vonuar pa penalizime, pasi detyrimi për tatim fitimin dhe TVSH për vitin 2013 janë në shumën 6,344,691 mijë lekë.

Menjëherë

21. Administratori i shoqërisë dhe Departamenti i burimeve njerëzore të marrin masat e nevojshme për të respektuar kërkesat e ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat në caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, duke miratuar nga ministri përkatës nivelin e pagës brenda kufirit minimal e maksimal të pagës të caktuar nga Këshilli i Ministrave, në varësi të mundësive financiare.

Menjëherë

22. Administratori i shoqërisë dhe departamentet përkatëse, të marrin masat e nevojshme që pagesa e shpërblimit të punonjësve në fund të vitit të jetë në përputhje me ligjin nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat në caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, si dhe me Kodin e Punës, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar.

Për çdo shpërblim në fund të vitit

23. Administratori i shoqërisë dhe departamentet përkatëse, të marrin masat e nevojshme paraprake për pagesën në kohë të tatimit të të ardhurave nga punësimi dhe kontributeve shoqërore e shëndetësore, për të shmangur penalizmin e KESH Sha, sepse gjatë vitit 2012, është penalizuar nga organet tatimore për pagesa të vonuara me gjoba dhe kamat vonesa në shumën 652,349 lekë.

Vazhdimisht

24. Administratori i shoqërisë dhe departamentet përkatëse, të analizojnë dhe të nxjerrin përgjegjësitë për penalizmin e KESH Sha si rezultat i vendimit të gjykatave për largime nga puna pa shkaqe të arsyeshme, pasi KESH Sha në periudhën 2012-2013 është penalizuar në 30 raste në shumën 28,303,821 lekë (në vitin 2012 nga vendimet e gjykatave në 20 raste në shumën 20,972,355 lekë, si dhe në vitin 2013 në 10 raste në shumën 7,331,466 lekë).

Menjëherë

25. Administratori i shoqërisë së KESH dhe departamentet përkatëse, të analizojnë dhe të marrin masa për të shmangur mangësitë e konstatuara në procedurat e prokurimit dhe zbatimin e kontratave në lidhje me:

- ndryshimin e kushteve kontraktore, pas shpalljes së ofertës fituese;
- përdorimin e referencave të markës në specifikimet teknike;
- çlirimin e garancisë së kontraktorit pa plotësuar detyrimin kontraktor;
- zhvillimin e procedurës “Negocim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës” në mungesë të kushteve ligjore përkatëse;
- prokurimin e materialeve të ndërtimit të ndaluara me VKM për përdorim;
- plotësimin e të gjitha kërkesave të DST, kryesisht në rastin e bashkimit të operatorëve;
- amendimin e kontratave për furnizim me mallra për shtesë afati, duke shmangur penalizmin e kontraktorit për vonesa në realizimin e tyre;
- tejkalimin e kompetencave në prokurime për autoritete të tjera kontraktore;

- përcaktimin me saktësi të fondit limit, duke marrë të dhëna edhe nga organet tatimore e doganore, si dhe të detajuar nga specialistë të fushave;
- prokurimin e blerjeve me vlera të vogla për mallra të së njëjtës natyrë dhe pa tejkaluar limitin e tyre vjetor.

Vazhdimisht

26. Departamenti i Auditit të Brendshëm të përfundojë hartimin e manualit specifik dhe Kartës së Auditit të Brendshëm të “KESH Sha”, në përputhje me Manualin e Auditit të Brendshëm, sepse duhej të ishte përfunduar brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e MAB.

Brenda vitit 2014

27. Departamenti i Auditit të Brendshëm të plotësojë formatin e riskut, si pjesë e programit të angazhimit të auditimit.

Menjëherë

28. Këshilli Mbikëqyrës, Administratori i shoqërisë dhe Departamenti i Auditit të Brendshëm, të marrin masa për të zbatuar Urdhrin e Kryeministrit nr. 70, datë 18.04.2006, “Për masat në zbatim të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Auditit të Brendshëm dhe Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion, në Këshillin e Ministrave, në institucionet në varësi të Kryeministrit a të ministrave” si dhe Udhëzimin nr. 12, datë 05.06.2012, i Ministrit të Financave, “Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”.

Vazhdimisht

29. Departamenti i Auditit të Brendshëm të marrë masat e nevojshme, që rekomandimet e dhëna të jenë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 21 “Përgjegjësitë e audituesve të brendshëm”, pika 7, pasi një numër i konsiderueshëm i tyre nuk i plotësojnë këto kërkesa.

Vazhdimisht

30. Këshilli Mbikëqyrës të evitojë ndryshimet e shpeshta të stafit të Departamentit të Auditimit, sepse për vitin 2013 ka ndryshuar tre herë Drejtori i Departamentit dhe ka lëvizje të shpeshta të audituesve, duke ndikuar negativisht në mbarëvajtjen dhe cilësinë e veprimtarisë audituese.

Vazhdimisht

31. Administratori i shoqërisë së KESH dhe Departamenti përkatës, të zbatojnë të me përpikmëri të gjitha kërkesat e Rregulloreve të ERE-s për shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike, duke plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm për të gjithë tregtarët vendas dhe të huaj me të cilët autoriteti blerës bashkëpunon ose ka marrëdhënie kontraktore gjatë viteve të fundit, brenda datës 30 nëntor të çdo viti, në përputhje me pikën 3, të nenit 10 të Rregullores “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të blerjes nga KESH Sha, së energjisë elektrike, nga tregtarët”.

Brenda datës 30 nëntor të çdo viti

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1.Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i shumës prej **1,171,590 lekë**, përfituar padrejtësisht nga anëtarët e këshillit mbikëqyrës shpërblim në fund të vitit 2012 dhe 2013, e cila përbën dëm ekonomik për shoqërinë.

2.Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i shumës prej **673,412 lekë**, përfituar padrejtësisht nga administratori dhe audituesit e brendshëm në kundërshtim me ligjin nr. 10405, datë 24.3.2011”Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6, pika 1; si dhe në kundërshtim me Kodin e Punës, neni 114, pika 2.

3.Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i shumës prej **766,908 lekë**, përfituar padrejtësisht në prill 2013 nga pesë anëtarët e Sekretariatit Teknik të Komisionit të Posaçëm të Trajtimin të Plotave, në kundërshtim me Rregulloren përkatëse.

4.Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i shumës prej **33,683,180 lekë**, përfituar padrejtësisht nga punonjësit e KESH Sha në muajin qershor 2013, në kundërshtim me ligjin nr. 10405, datë 24.3.2011”Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6, pika 1, shkronja (b).

5.Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i shumës prej **1,952,000 lekë** përfituar padrejtësisht nga punonjësit e KESH Sha për vitin 2012 dhe 2013 nga pagesat e shpenzimeve për udhëtim e dieta brenda vendit, në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”.

6.Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i shumës prej **684,702 lekë**, detyrime debitore për 93 punonjës të KESH Sha nga moslikuidimi i shpenzimeve sipas kontratave të telefonisë celulare për vitet 2012-2013.

7.Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i shumës prej **2,124,370 lekë** nga kontraktori “**██████**” Shpk, nga e cila 1,056,000 lekë si rezultat i vonësive dhe 1,068,370 lekë për punime të paguara por të parealizuar.

8.Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i shumës prej **3,304,517 lekë** nga kontraktori “**██████**” Shpk, nga e cila 604,800 lekë si rezultat i vonësive dhe 2,699,717 lekë për punime të paguara por të parealizuar.

9. Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i shumës prej **7,480 Euro**, nga kontraktori “” Ltd, si rezultat i vonesave prej 44 ditë, sipas nenit 4 të kontratës.

10. Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i shumës prej **3,071,350 lekë**, përfituar padrejtësisht nga subjekti “” SHPK, nga të cilat 2,029,190 lekë përfitime të padrejta për punime të paguara por të parealizuar dhe 1,042,160 lekë penalitete për vonesa në zbatimin e kontratës.

11. Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i shumës prej **5,404,800 lekë**, për subjektin “” Shpk për penalitet për 77 ditë vonesa në realizimin e kontratës, në kundërshtim me nenin 23 të saj,

MASA ADMINISTRATIVE

Referuar parregullsive dhe shkeljeve të ndryshme të konstatuara në prokurimet publike për periudhën 01.01.2012 deri më 31.12.2013, si dhe përgjegjësisë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në raportin përfundimtar të auditimit, bazuar në nenin 13 (pika “i”) dhe 72, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pikës 3, kreut X të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, **i kërkohet Agjencisë së Prokurimit Publik të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke rekomanduar marrjen e masave administrative dhe disiplinore për punonjësit si më poshtë:**

1. Z. në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor të KESH Sha,

- i ka kërkuar autoritetit kontraktor Koman në mënyrë indirekte shmangien e penalizmit për vonesa të kontraktorit në procedurën e prokurimit “Furnizim-Vendosje të elektropompave të reja të qarkullimit të vajit të kushinetave pasqyrë, Furnizim-Vendosje të radiatorëve ftohës për vajin e rregullatorëve të shpejtësisë, Furnizim pjesë rezervë të këmbimit të elektropompave horizontale në Stacionin e pompimit të Galerive të Pjerrëta”, duke kapërcyer kompetencat e tij në fushën e prokurimeve, pasi për kryerjen e kësaj procedure prokurimi është përgjegjës Autoriteti kontraktor HEC Koman.

- në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit në procedurën e prokurimit “Blerje pjesë rezervë për HEC Fierzë dhe Vau i Dejës”, ka rezultuar se për blerje pajisje “Kompjuter i centralogut të sallës së komandës”, është vendosur emërtimi i firmës prodhuese “”, pa vendosur përcaktimin “ose ekuivalent”, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 26.10.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 23, pika 5.

2. Z. në cilësinë e Drejtorit të Departamentit të Prokurimeve, në zbatimin e kontratës “Blerje pjesë rezervë për HEC Fierzë dhe Vau i Dejës”, me shkresën nr. 4926/1, datë 30.08.2013 ka kërkuar çlirimin e garancisë së kontraktorit, pa u përmbushur plotësisht detyrimet kontraktore, pasi nuk është bërë i mundur konfigurimi i dy pajisjeve sipas artikullit 37, “Shndërrues i frekuencave D.T.L”, për të cilat është mjaftuar vetëm me ndalimin i pagesës së pajisjeve të rikthyer kontraktorit, në kundërshtim me nenin 9.1, të kushteve të veçanta të kontratës, pa kërkuar kontraktorit zëvendësimin e pajisjeve brenda periudhës 30 ditore.

3. Z. [REDACTED] në cilësinë e anëtarit të Njesisë së prokurimit, pasi në procedurën e prokurimit “Blerje pjesë rezervë për HEC Fierzë dhe Vau i Dejës”, ka rezultuar se për blerje pajisje “Kompjuter i centralogut të sallës së komandës”, është vendosur emërtimi i firmës prodhuese “[REDACTED]”, pa vendosur përcaktimin “ose ekuivalent”, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 26.10.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 23, pika 5.

4. Z. [REDACTED] në cilësinë e anëtarit të Njesisë së Prokurimit, për procedurën e prokurimit “Blerje pajisje dhe bazë materiale për HEC Vau Dejës, HEC Fierzë dhe HEC Koman”, në DT kanë përcaktuar material termoizolues të ndaluar për përdorim, në kundërshtim me VKM nr. 447, datë 19.09.1994, si dhe në specifikimet teknike kanë përdorur kërkesa reference dhe marke, pa përfshirë detyrimisht në këto specifikime fjalët “ose ekuivalent”.

- në procedurën e prokurimit “Blerje pjesë rezervë për HEC Fierzë dhe Vau i Dejës”, ka rezultuar se për blerje pajisje “Kompjuter i centralogut të sallës së komandës”, është vendosur emërtimi i firmës prodhuese “[REDACTED]”, pa vendosur përcaktimin “ose ekuivalent”, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 26.10.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 23, pika 5.

5. Zi. [REDACTED] në cilësinë e anëtarit të Njesisë së Prokurimit, për procedurën e prokurimit “Blerje pajisje dhe bazë materiale për HEC Vau Dejës, HEC Fierzë dhe HEC Koman”, në DT kanë përcaktuar material termoizolues të ndaluar për përdorim, në kundërshtim me VKM nr. 447, datë 19.09.1994, si dhe në specifikimet teknike kanë përdorur kërkesa reference dhe marke, pa përfshirë detyrimisht në këto specifikime fjalët “ose ekuivalent”.

- në procedurën e prokurimit “Blerje pjesë rezervë për HEC Fierzë dhe Vau i Dejës”, ka rezultuar se për blerje pajisje “Kompjuter i centralogut të sallës së komandës”, është vendosur emërtimi i firmës prodhuese “[REDACTED]”, pa vendosur përcaktimin “ose ekuivalent”, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 26.10.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 23, pika 5.

6. Z. [REDACTED] pasi: - në cilësinë e anëtarit të Njesisë së Prokurimit, për procedurën e prokurimit “Blerje pajisje dhe bazë materiale për HEC Vau Dejës, HEC Fierzë dhe HEC Koman”, në DT kanë përcaktuar material termoizolues të ndaluar për përdorim, në kundërshtim me VKM nr. 447, datë 19.09.1994, si dhe në specifikimet teknike kanë përdorur kërkesa reference dhe marke, pa përfshirë detyrimisht në këto specifikime fjalët “ose ekuivalent”.

- në cilësinë e anëtarit të Komisionit të vlerësimit të ofertave në procedurën “Blerje rroba pune për nevojat e KESH Sha”, pasi operatori i përzgjedhur fitues nuk ka sjellë Certifikatën ISO 9001-2008 për mushama shiu, kapele, kokore, të gjitha llojet e dorezave, kominoshet dhe peshqirë dhe në zbatim të paragrafit të fundit të Kriteret e Veçanta të Kualifikimit: Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, konsiderohen si kushte për skualifikim, pra subjekti duhej të ishte skualifikuar.

7. Z. [REDACTED] pasi: në cilësinë e titullarit të Autoritetit kontraktor të Hec Fierzë pasi: ka zhvilluar procedurë dhe nënshkruar procedurën e prokurimit “Furnizim, instalim i 10 kompleteve pajisje on-line DGA për analizë e gazrave të çliruar dhe matjen e lagështirës së vajrave në transformatorët e fuqisë të HEC Vau i Dejës dhe HEC Fierzë” amendament shtesë kontrate për llogari të një Autoriteti tjetër kontraktor (Hec Koman), me procedurë me negociim, pa botim paraprak të njoftimit të kontratës është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 33, pika 3, pasi mallrat e kërkuara nuk janë prodhuar vetëm për qëllime kërkimi, eksperimentimi, studimi ose zhvillimi, por janë prodhime me shumicë për

qëllime tregtare; si dhe këto lëvrime shtesë nga furnizuesi i mëparshëm, me ndryshimin e furnizuesit nuk e detyrojnë autoritetin kontraktor të kërkojë mallra me karakteristika të ndryshme teknike, që mund të rezultojnë në papajtueshmëri dhe në vështirësi të mëdha teknike për vënien në punë apo mirëmbajtjen e tyre; në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, kreu i IV, pika 5: a); si dhe në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, kreu i I, pika 2, shkronja (a);

- Në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor Hec Fierzë gjatë zbatimit procedurave të prokurimit të blerjeve të vogla, përcaktimi i kufirit monetar për këtë procedurë, nuk është llogaritur për grup mallrash apo shërbimesh të ngjashme, në kundërshtim me VKM nr. 1., datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, kreu VI, pika 2, shkronja (a); është tejkaluar shuma vjetore e këtyre procedurave për të njëjtin mall, shërbim ose grup mallrash prej 400,000 lekë, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 1, datë 01.02.2013 të APP “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, pika 4; Për dy procedura për punime ndërtimi nuk janë hartuar kritere mbi ligjshmërinë e operatorëve pjesëmarrës që të jenë persona juridikë, në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, neni 8, paragrafi 1.

- Në zbatimin e procedurës së prokurimit dhe zbatimin e punimeve për Kontratën “Rehabilitimi i akseve të turbinave”, pa filluar zbatimin e kontratës, me shkresë nr. 124/3, datë 16.03.2012, ka njoftuar kontraktorin “” Shpk për miratimin e ndryshimeve të propozuara. Si pasojë e këtij veprimi, janë ndryshuar specifikimet, vizatimet dhe çmimet e realizimit të punimeve për njësi, pra projekti fillestar për realizimin e punimeve, duke ndryshuar tërësisht dokumentet e tenderit, **duke kaluar në negocim të drejtpërdrejtë për realizimin e punimeve të parashikuara.** Ndryshimi nuk ka të bëjë me seksione të caktuara apo ndryshime të cilat dalin të nevojshme gjatë zbatimit të kontratës, por para fillimit të punimeve janë ndryshuar tërësisht përcaktimet në dokumentet e tenderit, duke kaluar në negocim të drejtpërdrejtë për realizimin e punimeve. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 60, pika 1 dhe 2. Në pikën 1, të nenit 60 përcaktohet: “Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese”; **Negocimi i drejtpërdrejtë për këtë rast, përbën shkelje të barazisë në tendera si dhe mos mirëpërdorim të fondeve publike,** veprim i cili bie në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, kreu I, pika 1.b,d; Edhe pas këtyre ndryshimeve, të pa mbështetura ligjërisht, për vendosjen e çmimit të punimeve **është marrë vetëm oferta e paraqitur nga Kontraktori, pa asnjë justifikim analizë çmimi apo kostoje për realizimin e këtyre punimeve,** në kundërshtim me Udhëzimin e KM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”; për punimet e realizuara në Njësinë Vau-Dejës **është ndryshuar çmimi i konstruksioneve, duke i rritur ato në krahasim me çmimin e negociuar para fillimit të punimeve, duke shkaktuar dëm ekonomik me vlerë 2,699,717 lekë.**

8. Z. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor të Hec Koman për arsye se, gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit “Blerje dhe vendosje 4 elektropompa horizontale të reja me pjesët e këmbimit rezerve të tyre dhe instalimin e skemës së kontroll monitorimit automatik-manual në stacionet e pompimit të galerive të digës Koman”:

Ka urdhëruar fillimin e aplikimit të kësaj procedurë prokurimi me negocim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës me shkresën nr. 21/1, datë 17.04.2012, me afat të përgatitjes së

dokumentacionit teknik, mbi aktin teknik të gjendjes reale të elektropompave dhe hartimin përfundimtar të specifikimeve teknike, brenda datës 20.04.2012, **megjithëse ishte parashikuar në planin e prokurimit të vitit 2012.**

Përcaktimi i përdorimit të procedurës **“Procedurë me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit”**, nuk është justifikuar dhe bazuar ligjërisht, pasi kanë ekzistuar afatet kohore për zbatimin e procedurave standarde të prokurimit mbi ose nën kufirin e ulët monetar, si dhe nuk është vërtetuar, dokumentuar dhe argumentuar se ekzistojnë nevoja ekstreme apo situata emergjente, të cilat nuk janë shkaktuar nga veprimi a mosveprimi autoritetit kontraktor.

Gjithashtu, **nuk është vepruar me negocimin e blerjes së pajisjeve të nevojshme për kapërcimin e situatës së emergjencës lidhur me numrin e pajisjeve të dëmtuara**, por është zhvilluar procedurë prokurimi për kontratë normale, duke përfshirë një numër më të madh të pajisjeve në rrethana jo emergjente, duke krijuar premisa për uljen e efektivitetit të procedurave të prokurimit (rritje të kostos), veprime në kundërshtim me **VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu IV, Pika 5, iv.**

Veç sa më sipër, aplikimi i kësaj procedure ka shkaktuar pamundësinë e marrjes pjesë të operatorëve në procedurat e prokurimit publik, si dhe një trajtim jo të barabartë të tyre, **veprime të cilat bien në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 1, pika 2.ç,d**

9. Z. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të Njesisë së Prokurimit në Hec Koman për procedurën “Furnizim-Vendosje te elektropompave të reja të qarkullimit të vajit të kushinetave pasqyrë, Furnizim-Vendosje te radiatorëve ftohës për vajin e rregullatorëve të shpejtësisë, Furnizim pjesë rezerve të këmbimit të elektropompave horizontale në Stacionin e pompimit te Galerive të Pjerrëta” i ngarkuar për hedhjen e dokumentacionit në sistem, nuk janë sipas përcaktimeve në DST, të përcaktuara nga APP, pasi nuk janë vendosur Fondi limit i kontratës, Afati kohor për dorëzimin e ofertave, vlera mesatare e xhiros etj.

10. Z. [REDAKTUAR] pasi: në cilësinë e anëtarit të Komisionit të vlerësimit të ofertave në procedurën “Blerje rroba pune për nevojat e KESH Sha”, operatori i përzgjedhur fitues nuk ka sjellë certifikatën ISO 9001-2008 për mushama shiu, kapele, kokore, të gjitha llojet e dorezave, kominoshet dhe peshqirë dhe në zbatim te paragrafit të fundit të Kriteret e Veçanta të Kualifikimit: Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, konsiderohen si kushte për skualifikim, subjekti duhej të ishte skualifikuar.

11. Z. [REDAKTUAR] pasi: në cilësinë e anëtarit të Komisionit të vlerësimit të ofertave në procedurën “Blerje rroba pune për nevojat e KESH Sha”, operatori i përzgjedhur fitues nuk ka sjellë certifikatën ISO 9001-2008 për mushama shiu, kapele, kokore, të gjitha llojet e dorezave, kominoshet dhe peshqirë dhe në zbatim te paragrafit të fundit të Kriteret e Veçanta të Kualifikimit: Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, konsiderohen si kushte për skualifikim, subjekti duhej të ishte skualifikuar.

D. MASA DISIPLINORE

Bazuar në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 37, si dhe Kontratën kolektive të punës nr. 1524

prot., datë 27.03.2013 të nënshkruar midis KESH Sha dhe Sindikatës së Pavarur të Punonjësve të Elektroenergjetikës Shqiptare dhe Federatës Sindikale të Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë, neni 62 **kërkojmë nga Administratori i KESH Sha të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore:**

I “Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra” për:

1. Z. [REDAKTUAR] me detyrë Drejtor i Departamentit Ekonomik, pasi: ka lejuar blerjen e biletave të avionit në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, “Për prokurimin publik” dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi;

- ka firmosur fletët e udhëtimit për dy automjete në periudhën 16.05.2013 – qershor 2013, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, dhe Udhëzimin nr. 30, të Ministrisë së Financave, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, të cilat nuk justifikojnë vlerën e dokumentacionit financiar mbështetës dhe justifikues;

II “Vërejtje” për:

1. Z. [REDAKTUAR] në detyrën e Drejtorit të Kabinetit pasi:

- Nga auditimi i kryer për shpenzime udhëtimi jashtë vendit rezultoi se në 15 raste për vitin 2012 dhe në 13 raste për vitin 2013, për pagesat e kryera për shërbimet jashtë shtetit, në valutë, rezulton se mungojnë ftesat nga pala pritëse, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, dhe me VKM nr. 870, datë 14.12.2011, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”;

- Ka firmosur fletët e udhëtimit për dy automjete në periudhën janar 2012 - 14.05.2013, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, dhe Udhëzimin nr. 30, të Ministrisë së Financave, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, të cilat nuk justifikojnë vlerën e dokumentacionit financiar mbështetës dhe justifikues

2. Z. [REDAKTUAR] me detyrë specialist finance, pasi: nga auditimi i kryer për shpenzime udhëtimi jashtë vendit rezultoi se në 15 raste për vitin 2012 dhe në 13 raste për vitin 2013, për pagesat e kryera për shërbimet jashtë shtetit, në valutë, rezulton se mungojnë ftesat nga pala pritëse, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, dhe me VKM nr. 870, datë 14.12.2011, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”.

3. Z. [REDAKTUAR]

4. Z. [REDAKTUAR]

5. Z. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarëve të komisionit negociues për shtesë kontrate të procedurës “Furnizim, instalim i 10 kompleteve pajisje on-line DGA për analizë e gazrave të çliruar dhe matjen e lagështirës së vajrave në transformatorët e fuqisë të HEC Vau i Dejës dhe HEC Fierzë”, ka tejkaluar kompetencat duke propozuar procedurën këtë shtesë kontrate, megjithëse nevojat kane qenë për një pajisje, janë negociuar dy të tilla, si dhe është negociuar për autoritet tjetër kontraktor (Hec Koman).

F. KALLZIM PENAL

Bazuar në nenet: 164 të shpërdorimit të kompetencave, 248 të shpërdorimit të detyrës dhe 258 të shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike të Kodit Penal, sugjerojmë trajtimin e detajuar tekniko juridik nga ana e Drejtorisë Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut, të materialeve të evidentuara nga grupi i auditimit, në kuptim të referencave të mësipërme, për 2 persona:

Shënim: Gjatë trajtimit të çështjeve në Raportin e auditimit janë konstatuar përgjegjësi të natyrës drejtuese dhe manaxhuese për: z. [] në cilësinë e Administratorit të KESH Sha; z. [], në cilësinë e Drejtorit të Divizioni i Furnizimit Publik; z. [] në cilësinë e Drejtorit të Departamentit të Prokurimeve; z. [] në cilësinë e Drejtorit të Departamentit Ekonomik; z. [] në cilësinë e Shefit të Sektorit të Shërbimeve; zj. [] në cilësinë e Drejtores së HEC Vau i Dejës; z. [] në cilësinë e Drejtorit të HEC Fierzë; si dhe zj. [] në cilësinë e specialistes së financës. Meqenëse personat e sipërpërmendur kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me KESH Sha, si dhe nuk ka adresim institucional për dhënien, ndjekjen e zbatimin e tyre, **për masën e largimit nga detyra të njoftohet Departamenti i Administratës Publike.**

Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Gjovalin Preçi, Artan Topiana, Mimoza Bedini, Andi Buzo, Lolita Baholli, më tej u shqyrtua nga k/auditues Bashkim Arizaj, Drejtori i Departamentit Xhafer Xhorxhaj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktike nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT